REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 896, 912/20
Datë/Datum. 19.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Hasim Krasniqi	11.11.2020	19.11.2020	896/20, dhe 912/20.

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **06.11.2020**, OE "**Rojet e Nderit Sh.p.k**"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **896/20**, si dhe me datën: **09.11.2020**, OE "**K.S.Besa Security Sh.p.k.**"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **912/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE"**Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove**"- Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës**" me nr. të prokurimit: **616-19-3238-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Kuvendi Komunal-Prishtinë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **2.100.000,00 €.**

Ankesa është e përsëritur ky aktivitet është trajtuar edhe me **Vendimi e OSHP-së, PSH 735-744-757/19 dt.09.12.2019, Vendimi e OSHP-së, PSH 82-83-92/20 dt.03.03.2020, Vendimi e OSHP-së, PSH 332/20 dt.25.05.2020 si dhe Urdhëresa e OSHP-së, PSH 563/20 dt.14.10.2020.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE Ankesa 896/20

Dispozitat e shkelura sipas, OE "**Rojet e Nderit Sh.p.k**"- Prishtinë, e cila ka parashtruar ankesë me nr: **896/20**, janë:
Neni 1 Qëllimi
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës,
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.
Neni 65 Kriteret për Dhënien e Kontratës.
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.
Dosja e tenderit,
Vendimi i OSHP,
Rregulloret për vlerësim tenderit etj.

pikat e ankesës:

OE ankuese ka parashtruar ankes përveq që në disa faqe të ankeses ka parqitur- përshkruar kronologjin rreth veprimeve të marra nga AK dhe OSHP lidhur me këtë aktivitet, ka paraqitur pretendim lidhur me vendimin e fundit të marrur nga Menaxheri i Prokurimit i AK-së duke u thirrur në urdhresen e OSHP-së, si dhe në dokumentacionin e grupit te OE te rekomanduar për kontratë respektivisht në oferten financiare deshmit lidhur me vërtetimin e ATK-së të International Security Association SHPK si dhe pretendimet se "Nazeri SHPK" ka masë administrative të 137shuar nga institucionet e Shqiprisë si dhe për drejtuesin tjeter të kësaj kompanie Mehmet Bazaj me arsytim se i njejti është denuar nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Durres për vepër penale Shperdorim Detyre dhe nga keto dokumente konstatohet se ky OE nuk i përmbush kriteret e percaktuara nga AK në dokumentacionin e tenderit.

- Per me teper referonju deklarates ne ankesen e paraqitur pran OSHP-se nga ana e operatorit ankues nr.896/20.

Dëmet materiale

Mundesia e nenshkrimit te kontrates , stresi i shkaktuar dhe koha e humbur.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, me perjashtim te pretendimeve rreth dokumentacionit respektivisht stafit te OE "Nazeri SHPK" nderlidhur me vendimet e nxjerrura në Shqipëri, pretendimet tjera janë te njëjta me pretendimet e parashtruara nga OE me kërkesen për rishqyrtim në AK.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE Ankesa 912/20

Dispozitat e shkelura sipas OE "**K.S.Besa Security Sh.p.k.**"- Prishtinë, e cila ka parashtruar ankesë me nr: **912/20**, janë:

Neni 1,
Neni 7,
Neni 56.3,
Neni 57,
Neni 59,
Neni 61,
Neni 72.

pikat e ankesës:

OE ankuese ka parashtruar ankes, ka paraqitur pretendim lidhur me vendimin e fundit të marrur nga Menaxheri i Prokurimit i AK-së duke u thirrur në urdhresen e OSHP-së pa bërë vlerësim dhe krahasim të ofertave, si dhe në dokumentacionin e grupit te OE te rekomanduar për kontratë respektivisht në oferten financiare respektivisht mos plotësimit të kushtit prej 250 € pagë për punëtor dhe pretendimin rreth çmimeve jo normalisht të ulëta.

- Per me teper referonju deklarates ne ankesen e paraqitur pran OSHP-se nga ana e operatorit ankues nr.912/20.

Demet materiale

Ne konsiderojm se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilën pësojmë në aspektin financiar, shpenzimet e pregaditjes së tenderit, sigurimi i tenderit, shpenzimet e ankesës, largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektivë dhe imazh të kompanisë tonë, fitimi i planifikuar për këtë tender.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta me pretendimet e parashtruara nga OE me kërkesen për rishqyrtim në AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.4) Kërkesat-Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme,) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).*
1. *OE DUHET TE DEKLAROHET SE PUNETOREVE DO TUA PAGUAJ PAGEN MINIMALE BRUTO 250€*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. *Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve. a) Kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca të lëshuara nga autoriteti i tillë. b) Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, duhet të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca të lëshuara nga blerësi i tillë.*
2. *DEKLARATA E NENSHKUAR DHE E VULOSUR NGA OE*

Kriteret e Dhënies

Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në shkresat e lendes të cilat gjenden në platformen e E-prokurimit **Menaxheri i prokurimit i AK pas pranimit të Urdhëreses se leshuar nga OSHP-së, PSH 563/20 dt.14.10.2020 ka marr vendim me të cilin ka konstatuar si në vijim:**

Republika e Kosovës
Komuna e Prishtinës

Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë, 19.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtines, sipas urdhereses se OSHP-se numer 563/20 te dates 14.10.2020;ne baze të nenit 59 pika 1 e LPP-ik numer 04/L-042 dhe nenit 40.13 te RRUOPP-se,nxjerr :

V E N D I M

PER REKOMANDIM TE DHENJES SE KONTRATES SIPAS URDHERESES

Urdheresa e OSHP-se ka detyruar Autoritetin Kontraktues qe te zbatoj me perpikeri Vendimet paraprake me numër 332/20 dhe 82,83 dhe 90/20.Bazuar ne urdherese Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka analizuar me kujdes këto Vendime dhe rekomandimet nga urdhëresa dhe ka konstatuar si vijon:
-Me Vendimin numër 82,83,90/20 tri ankesa te OE-ik"ISA SHPK&Nazeri 2000";"Besa Security";dhe "Rojet e Nderit"janë trajtuar si pjesërisht te bazuara dhe eshte konstatuar se OE-ik i propozuar per dhenje te kontratës eshte i pa papërgjegjshëm.Ne baze te këtij Vendimi eshte bere rivlerësimi i aktivtetit dhe eshte propozuar per dhenje te kontratës OE-ik "Rojet e Nderit".Ne kete rekomandim eshte ankuar OE-ik "Isa&Nazeri"dhe Paneli i OSHP-se ka trajtuar kete ankese si te bazuar ne Vendimin numër 332/20.
Autoriteti Kontraktues ka bere përpjekje qe te respektoj te gjitha rekomandimet nga Vendimi i lartecekur,por sipas Urdhereses se OSHP-se rrjedh se te njëjtat nuk janë respektuar sa duhet.Vlen te ceket se sipas Urdhereses rezulton se nuk mund te behet anulimi i aktivitetit,nëse nuk plotësohen kërkesat e nenit 62 te LPP-se,prandaj Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk plotësohen te njëjtat dhe per kete eshte i detyruar qe aktivitetin ta permbyll me Vendim per dhenje te kontratës.

Bazuar ne faktin se OE-ik "Rojet e Nderit"ka qene i rekomanduar per dhenje te kontratës,por qe eshte konstatuar nga Urdheresa se nuk eshte propozim ne pajtim me Vendimet paraprake te OSHP-se dhe se OE-ik "Besa Security"ka kërkuar anulimin e aktivitetit konstatoj se te njëjtit nuk mund te jene edhe me tutje kandidat qe mund te rekomandohen per dhenje te kontratës.Sipas këtij konstatimi rrjedh se vetëm ankesa e OE-ik "Isa&Nazeri"eshte OE-ik ne te dy Vendimet e cekura ne urdherese eshte trajtuar si e bazuar dhe sipas rekomandimit te përsëritur disa here ne te gjitha Vendimet e

OSHP-se per respektim te nenit 1 te LPP-se.Bazuar ne kete rrjedh se ky eshte OE-ik i vetëm i përgjegjshëm sipas Vendimeve te cekura ne Urdherese dhe Zyrtari përgjegjës i prokurimit e propozon te njejtin per dhenje te kontratës me çmimin total per tridhjete e gjashte muaj prej 2.379,456.00 euro(çmimi per ore pune 1.70 euro).

A r s y e t i m

Zyrtari pergjegjes prokurimit ka analizuar te gjithe aktivitetin duke perfshire te gjitha Vendimet e OSHP-se dhe veprimet e Autoritetit Kontraktues dhe konstaton se e vetmja mangesi ne tere kerkesat e AK-se ka qene fakti se ne disa pozicione per sigurim nuk ka percaktuar numrin e oreve te nates(pozitat 8 ore,12 ore dhe 16 ore)dhe kjo ka dhene mundesi te interpretimeve te ndryshme lidhur me kerkesen e AK-se per analize financiare dhe ka shkaktuar ankesa te vazhdueshme.Autoriteti Kontraktues edhe sipas interpretimit te ATK-se ka konstatuar se disa OE-ik perfshire edhe OE-ik qe tani rekomandohet per kontrate nuk kane ofruar analize e cila deshmon se mund te paguajne pagat bruto prej 250.00 euro per punetor,por kjo eshte refuzuar nga eksperti shqyrtues dhe Paneli i OSHP-se,me arsyetimin se sipas Rregullave per tenderet jonormalisht te ulet AK-ja nuk ka pase te drejte te kerkoj sqarime per qmimet e dhena nga tenderuesit.

Bazuar ne te gjitha keto atehere mbetet qe OE-ik i propozuar per dhenje te kontrates te respektoj te gjitha deklarimet e tij ne oferte duke perfshire edhe deklarimin se do te paguaj pagat bruto prej 250.00 euro.

Perfundim:
Nga te gjitha argumentet e paraqitura kam vendosur qe te respektoj sa me drejte Urdheresen e OSHP-se dhe sipas te gjitha analizave nga dokumentet paraprake rekomandoj qe ne kete aktivitet per dhenje te kontrates te rekomandohet OE-ik "ISA SHPK&Nazeri 2000"me çmimin total per periudhen tridhjete e gjashte mujore prej 2.379,456.00 euro,respektivisht me çmimin prej 1.70 € per ore pune.

Obligohet zyrtari qe administron kete aktivitet qe te publikoj menjehere Njoftimin e AK-se per kete Vendim dhe njekohesisht te njoftoj lidhur me kete Organin Shqyrtues te Prokurimit si deshmi per respektim te Urdhereses.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

(Zeke Bardhaj)

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden në platformen e e-prokurimit që janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatoret ekonomik pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Duke u bazuar në shkresat e lëndes, mendoj se operatoret ekonomik ankues janë palë interesi në këtë aktivitet të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Rojet e Nderit Sh.p.k" – PRISHTINË -Ankesa 896/20

Duke u mbeshtetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigjje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 10, 59, 60, 65 dhe 72 të LPP-së dhe vendimet e OSHP-së, me arsytimin se:

"OE ankuese ka parashtruar ankes përveq që në disa faqe të ankeses ka parqitur-përshkruar kronologjin rreth veprimeve të marra nga AK dhe OSHP lidhur me këtë aktivitet"

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se OE ankuese vetem ka bërë pershkrim kronologjik të rrjedhes së aktivitetit duke potencuar disa nga kërkesat dhe sqarimet e bëra nga AK në fazen para dorëzimit të ofertave e të cilat kerkesa kanë qenë pretendime dhe janë trajtuar me vendimet e OSHP-së nr.735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, Vendimi e OSHP-së, PSH 82-83-92/20 dt.03.03. 2020, Vendimi e OSHP-së, PSH 332/20 dt.25.05.2020 si dhe Urdhëresen e OSHP-së, PSH 563/20 dt.14.10. 2020.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese" *lidhur me vendimin e fundit të marrur nga Menaxheri i Prokurimit i AK-së duke u thirrur në urdhresen e OSHP-së"* duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuese **është pjesrisht i bazuar** sepse bazuar në nenin 59 të LPP-së AK respektivisht ZKA dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet të krijoj komision vlerësimi për vlerësim të tenderve respektivisht në paragrafin 40.1 dhe 40.2 të RRUOPP, ku theksohet :"*40.1 Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së,* ***për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht "ZKA" në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës te prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit*** *të tenderëve me funksione krejtësisht këshilluese për Zyrtarin përgjegjës te Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen aktivitetet e prokurimit me vlere minimale. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për Komisionin. Anëtaret e komisionit te hapjes se tenderëve mund te shërbejnë si anëtar te komisionit te vlerësimit.*

40.2 Komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast. Komisioni i vlerësimit do të vlerësoj tenderët në pajtim me kriteret e specifikuara me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si më i mirë."

Në rastin konkret zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK ka marr vendim duke u bazuar në paragrafin 40.13 të RRUOPP, ku theksohet : "*40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim.* ***Ne situata te tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund te nxjerr vendimin përfundimtar ose mund te formoj komision te ri për ri-vlerësim****. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim."*

Mirëpo i njëjti zyrtar respektivisht AK me rastin e publikimit të formularit "B58 Formularit mbi vendimin e autoritetit kontraktues" në platformen e E-prokurimit nuk i ka bashkangjtur letrat standarte siç parashihet me paragrafit 43.2 të RRUOPP, ku theksohet: *"43.2 Formulari B58 duhet te përmbajë* ***vendimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit dhe Letrat Standarde përkatëse per Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme****"*, por me rastin e publikimit të formularit B58 të njëjtit i është bashkangjitur vetëm Vendimi i marrur nga zyrtari përgjegjes i prokurimit i dates 19.10.2020.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese *"se në dokumentacionin e grupit te OE te rekomanduar për kontratë*

respektivisht në oferten financiare deshmit lidhur me vërtetimin e ATK-së të International Security Association SHPK" duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet lidhur më oferten financiare respektivisht çmimeve në ofertë, të njejtat pretendime janë trajtuar me vendimet e OSHP-së nr.735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, Vendimi e OSHP-së, PSH 82-83-92/20 dt.03.03. 2020, Vendimi e OSHP-së, PSH 332/20 dt.25.05.2020 si dhe Urdhëresen e OSHP-së, PSH 563/20 dt.14.10. 2020.

Ndersa, lidhur me pretndimin e OE ankuese, rreth vërtetimin te ATK-së të antarit të konzorciumit "International Security Association SHPK" duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim **nuk është i bazuar** sepse ky aktivitet i prokurimit është shpallur/publikuar nga AK në platformen e E-prokurimit me datën 20.05.2019 ndersa antari i konzorciumit të rekomanduar për kontratë "International Security Association SHPK" ka dorëzuar Vërtetimin e ATK-së, te nxjerrur me datën 11.04.2020, në të cilin është theksuar se *"është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura"* andaj vërtetimi si i tillë, plotëson kërkesen e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese *si dhe pretendimet se "Nazeri 2000 SHPK" ka masë administrative të leshuar nga institucionet e Shqiprisë si dhe për drejtuesin tjeter të kësaj kompanie Mehmet Bazaj me arsytim se i njejti është denuar nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Durres për vepër penale Shperdorim Detyre dhe nga keto dokumente konstatohet se ky OE nuk i përmbush kriteret e percaktuara nga AK në dokumentacionin e tenderit."* duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e larte cekura operatori ekonomik ankues nuk i ka parashtruar me kërkesen për rishqyrtim në AK, andaj pretendimet ne fjale nuk jane trajtuar nga eksperti shqyrtues ne perputhje me paragrafin 1 te nenit 109 te LPP-se dhe nenin 9 te "*Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave''.*

Përkundër kësaj duke pas parasysh faktet e ofruara me ankesen e dorëzuar nga OE ankuese ndaj dokumentacionit/dëshmive të antarit të konzorciumit të rekomanduar për kontratë OE "Nazeri 2000 SHPK", eksperti shqyrtues mendon se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave duhet ti marr parasysh pretendimet e OE ankuese dhe të verifikoj dëshmit e të antarit të konzorciumit të rekomanduar për kontratë OE "Nazeri 2000 SHPK" .

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "K.S.Besa Security Sh.p.k."- PRISHTINË -Ankesa 912/20

Duke u mbeshtetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigjje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 56.3, 57, 59, 61 dhe 72 të LPP-së, me rastin e refuzimit te tenderin tone me arsytimin:

"OE ankuese ka parashtruar ankes, ka paraqitur pretendim lidhur me vendimin e fundit të marrur nga Menaxheri i Prokurimit i AK-së duke u thirrur në urdhresen e OSHP-së pa bërë vlerësim dhe krahasim të ofertave"

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuese **është pjesrisht i bazuar** sepse bazuar në nenin 59 të LPP-së AK respektivisht ZKA dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet të krijoj komision vlerësimi për vlerësim të tenderve respektivisht në paragrafin 40.1 dhe 40.2 të RRUOPP, ku theksohet :"*40.1 Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së, për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht "ZKA" në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës te prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione krejtësisht këshilluese për Zyrtarin përgjegjës te Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen aktivitetet e prokurimit me vlere minimale. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për Komisionin. Anëtaret e komisionit te hapjes se tenderëve mund te shërbejnë si anëtar te komisionit te vlerësimit.*

40.2 Komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast. Komisioni i vlerësimit do të vlerësoj tenderët në pajtim me kriteret e specifikuara me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si më i mirë."

Në rastin konkret zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK ka marr vendim duke u bazuar në paragrafin 40.13 të RRUOPP, ku theksohet : "*40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim.* ***Ne situata te tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund te nxjerr vendimin përfundimtar ose mund te formoj komision te ri për ri-vlerësim****. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim."*

Mirëpo i njëjti zyrtar respektivisht AK me rastin e publikimit të formularit "B58 Formularit mbi vendimin e autoritetit kontraktues" në platformen e E-prokurimit nuk i ka bashkangjtur letrat standarte siç parashihet me paragrafit 43.2 të RRUOPP, ku theksohet: *"43.2 Formulari B58 duhet te përmbajë **vendimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit dhe Letrat Standarde përkatëse per Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme**"*, por me rastin e publikimit të formularit B58 të njëjtit i është bashkangjitur vetëm Vendimi i marrur nga zyrtari përgjegjes i prokurimit i dates 19.10.2020.

Lidhur me pretendimet e OE ankuese *"ndaj dokumentacionit te grupit te OE te rekomanduar për kontratë respektivisht në oferten financiare respektivisht mos plotësimit të kushtit prej 250 € pagë për punëtor dhe pretendimin rreth çmimeve jo normalisht të ulëta"* duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet lidhur më oferten financiare respektivisht çmimeve në ofertë, të njejtat pretendime janë trajtuar me Vendimin e OSHP-së nr.735-744-757/19 të dt.21.10.2019, Vendimin e OSHP-së, PSH 82-83-92/20 dt.03.03.2020,Vendimin e OSHP-së, PSH 332/20 dt.25.05.2020 si dhe Urdhëresen e OSHP-së, PSH 563/20 dt.14.10.2020.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si **pjesërisht te bazuara**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës si dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Kuvendi Komunal-Prishtinë**.
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **"Rojet e Nderit Sh.p.k"**- Prishtinë.
  – **"K.S.Besa Security Sh.p.k."**- Prishtinë.